



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në përputhje me nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës Nr.06/L-055, Ligjin për Gjykatat Nr.06/L-054, neni 2A të Rregullores nr.04 /2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (01/2014) për procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve (të ndryshuar dhe plotësuar) dhe Vendimit KGJK Nr. 80/2024 të datës 29 Mars 2024, shpall:

KONKURS I BRENDSHËM PËR POZITËN
GJYQATAR – GJYKATA SUPREME – LËMIA CIVILE

TRI (3) POZITA

KRITERET

- për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Supreme, gjyqtari duhet të ketë së paku tetë (8) vite përvojë si gjyqtar;

Gjyqtari i cili aplikon për ngritje në detyrë në Gjykatën Supreme, Dhomë të Posaçme të Gjykatës Supreme, Gjykatën e Apelit dhe Dhoma të shkallës së dytë në Gjykatën Komerciale, përveç kushteve të veçanta për gjyqtarë të paraparë me nenin 32 të Ligjit nr.06/L-054 për Gjykata dhe nenin 15 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale duhet të plotësojë dhe kushtet si në vijim:

- 1.1 të ketë vlerësim të performancës në tre (3) vitet e fundit në shkallën ‘‘shkëlqyeshëm’’ ose ‘‘shumë mirë’’
- 1.2 të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore, përjashtimisht masën vërejtje jo publike me shkrim.

FORMULARI I APLIKIMIT

- formularin mund ta shkarkojnë në Ueb faqen e KGJK-së. (www.gjyqesori-rks.org)

[Shkarko Aplikacionin](#)

AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

Formularët për aplikim dorëzohen, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi i konkursit, Sekretariatit e KGJK-së, Rruga “Luan Haradinaj” nr. 133, Prishtinë në Zyrën e Pranimit.

Data e fillimit të aplikimi: 12 prill 2024

Data e fundit të aplikimit: 23 prill 2024

RREGULLAT DHE PROCEDURAT

Kandidatëve që aplikojnë për pozitat përkatëse do t`ju kërkohen dokumente të ndryshme për të mbështetur aplikacionin e tyre. Lidhur me këtë çështje, secili kandidat do të kontaktohet individualisht dhe përmes e -mail adresave për t`ju dërguar formularët dhe detajet për procedurat e mëtutjeshme.